# STATUT - AKT THEMELIMI

Sot, në datën 07/02/2019 (dymijë e nentembedhjete) personi meposhtem:

- **Z.Arben ZANE**, i biri i Rushan Zane dhe i Dallendyshe Zane, i datelindjes 03 Mars 1971, i lindur ne Berat, banues ne Tirane, Rruga "Frank Bardhi", Nr. 160, me shtetesi shqipetare, madhor, zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. Nr.033324168 dhe numer personal H10303080T;

ne cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire pivate, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", vendosi te themeloje shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "AUTO VIP ALBANIA" **SHPK.**

## Neni 1
## Formulimi

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur AUTO VIP ALBANIA sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohetlegjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

## Neni 2
## Zyra Qendrore e Shoqerise

Zyra Qendrore e shoqerise tregtare "AUTO VIP ALBANIA" sh.p.k do te jete NJESI N1 e ndodhur ne Selite Tirane, Rruga *"Frang Bardhi" ND 120 ,D 2 SELITE Farke ,1044 Tirane, ZK.3292, sipas Çertifikates per Vertetim pronesie nr.558100, te leshuar nga ZRPP Tirane date 31.01.2013 .*

Shoqeria mund te ndryshoje zyren qendrore te saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese , ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortaku.

## Neni 3
## Objektivi i Veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e : **Eksport - import dhe tregetim** automjetesh,motorash dhe bicikleta, të çdo lloji, makineri dhe pajisje të ndryshme industriale dhe bujqësore si dhe pjesë këmbimi te reja dhe te perdorura për automjete dhe makineri.

export import dhe tregetim te metaleve te ndyshme dhe skrapit

,export import te mbteje te riciklueshme

-Dhenia me qira e mjeteve.

Transport mallrash dhe/ose udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit.

Tregtimin e materialeve të ndërtimit, të lëndëve të para të ndërtimit brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport , tregtimi me shumicë dhe pakicë i gjeneratorëve të llojeve të ndryshme. Riparimi dhe mirëmbajtja e tyre. Prodhimi dhe shitblerja e energjisë alternative. Zhvillim aktiviteti në fushën e hoteleri turizëm, përfshirë hotel, motel, bar, restorant, diskoteka, qendra pushimi dhe qendra kurative, agjenci turizmi etj.

Kryerja e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve (servis, pikë larje makinash gomisteri etj).

Aktivitete ndërmjetësimi në formën e agjentit tretar të shoqërive vendase dhe të huaja. Për realizimin e veprimtarive të saj , shoqëria ka të drejtë të hapë njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregtimi vetë ose duke bashkëpunuar me persona fizike ose juridike, vendas ose të huaja.

Marrja përsipër e projektimit dhe/ose zbatimit të punimeve të montimit të teknologjive, impianteve industriale, të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike etj. dhe/ose shërbimet e mirëmbajtjes së tyre. Realizimi i projektimit dhe/ose zbatimit të veprave të veçanta dhe punimeve speciale si sillosa, kulla, punime themeli, vepra hidroteknike, vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime detare, rrugë, porte, aeroporte etj. dhe/ose shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Marrja përsipër dhe realizimi i studimeve, kërkimeve dhe/ose hartimi i projekteve teknike në fusha të ndryshme në lidhje kryesisht me aktivitetet në fushën e ndërtimit, por jo vetëm. Krijimi i sipërmarrjeve industriale ose teknike në përgjithësi dhe tregtimi i produkteve të tyre brenda dhe jashtë vendit. Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve industriale, pajisjeve të ndryshme dhe aparateve të cilat përdoren për qëllime të veçanta si dhe projektimi /zbatimi i çdo vepre

Tregtim karburantesh të ndryshme, gazit të lëngshëm, vajra lubrifikante, lëndë djegëse të çdo lloji dhe kategorie dhe distribucioni i tyre. Tregtim, import-eksport, i materialeve të ndryshme në fushën e ndërtimit, përfshire lëndë të para apo të përpunuara.

Import-eksport, tregtimin me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, ushqimore, industriale, bujqësore, blegtori, bimë medicinale e eterovajore, kozmetikë e estetikë, konfeksione dhe tekstile etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve elektro-shtëpiake, elektronike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj.

**Neni 4**
**Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e rregistrimit ne QKB. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku me vendim te ortakut .

**Neni 5**
**Kapitali i Shoqerise**

Kapitali i regjistruar i shoqerise është **50.000 Lek** (pesedhjete leke), i barabarte me 1 (nje) kuote. Kontributet e ortakut perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

| Nr. | Emri i Ortakeve | Kuota | Kontributi i ortakut ne kapital (leke) | Perqindja ne kapital |
|---|---|---|---|---|
| 1. | **Z.Arben ZANE** | 1 | 50.000 | 100 |
| **Totali** | | **1** | 50.000 | **100 %** |

5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakut te vetem te shoqerise.

**Neni 6**
**Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimisë
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar në .

**Neni 8**
**Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj , ortaku i vetem ortaku i vetem dhe perfaqesuesi ligjor i saj . Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
a) ndryshimin e statutit;
b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën c dhe d të kësaj pike;
e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
g) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
j) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asmablesë;
k) çështje të tjera të parashikuara në ligj apo statut;
Ortakët mund të përfqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asmablesë së përgjithshme e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9**
**Administrimi**

Shoqeria do te drejtohet nga administrator i shoqërisë i caktuar **Z.Arben ZANE**, i biri i Rushan Zane dhe i Dallendyshe Zane, i datelindjes 03 Mars 1971, i lindur ne Berat, banues ne Tirane, Rruga "Frank Bardhi", Nr. 160, me shtetesi shqipetare, madhor, zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. Nr.033324168 dhe numer personal H10303080T.

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratori do te qendroje ne detyre deri ne revokimin ose doreheqjen e tij per nje periudhe afati maksimal i te cilit do te jete 5 (pese) vjet .

**Neni 10**
**Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKB;
g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithsme në lidhje me zbatimin e politikave dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë ë Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të clat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat financiare të certifikuara;
- shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ortaku i vetem themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale

Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

**Neni 11**

**Viti Financiar-Ekspertët**

Viti finaciar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

**Neni 12**

**Prishja dhe Likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30-ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të cakatuar një likuidues.

**Neni 13**

**Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi-Ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**Neni 14**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të

zbatohen dispozitat e ligjit "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë

**Neni 15**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje m zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mdis Shoqërsë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 16**

**Dispozita të përgjithëshme**

Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje , nje kopje per t'u depozituar ne QKB dhe tre kopje do te mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise "AUTO VIP ALBANIA" sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem .

**Ortak i vetem themelues i**

**"AUTO VIP ALBANIA" sh.p.k**

**Arben ZANE**